

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR
MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE
SPITALORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor në mënyrë të pashmangshme gjeneron mbetje, disa që dalin në mënyrë specifike nga diagnostikimi dhe trajtimi dhe disa të ngjashme me ato të çdo familjeje. Mbetjet spitalore mund të jenë të rrezikshme dhe jo të rrezikshme dhe është e domosdoshme që menaxhuesit e mbetjeve dhe profesionistët e shëndetit brenda institucionit shëndetësor të jenë në gjendje të identifikojnë dhe ndajnë që në burim këto dy lloje mbetjesh. Vlerësimi i rrezikut është i nevojshëm në kontekstin e mbrojtjes së personelit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Nisur nga sa më sipër si dhe nga problematika të tjera të identifikuara si pasojë e gjenerimit në sasi të konsiderueshme të mbetjeve spitalore, detyrimit të lindur nga neni 35, i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, është hartuar akti nënligjor. Akti i propozuar ka për qëllim të ofrojë kërkesa për prodhuesit e mbetjeve (gjeneruesit) dhe grumbulluesit e tyre, për t’i ndihmuar ata të veprojnë në përputhje me kërkesat ligjore, të rrisë dhe mbrojë sigurinë dhe shëndetin publik, të sigurojë një mjedis më të sigurt pune, të minimizojë gjenerimin e mbetjeve dhe ndikimin mjedisor të trajtimit dhe asgjësimit të tyre. Objektivi i këtij akti lidhet me përcaktimin e kërkesave që synojnë të disiplinojnë menaxhimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit. Në akt janë të përcaktuara kërkesat lidhur me grumbullimin, ambalazhimin, etiketimin, ruajtjen e përkohshme, trajtimin dhe asgjësimin në mënyrë të kontrolluar të mbetjeve spitalore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA
POLITIKE

Ky projektakt është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2022 dhe vjen si detyrim i nenit 35 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

Projektakti është i parashikuar dhe është në përputhje me VKM nr.418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Akti i propozuar është më i detajuar në përmbajtje krahasuar me aktin e vjetër të miratuar në vitin 2010. Detyrat që kanë menaxhuesit e mbetjeve lidhur me grumbullimin, transportin, ambalazhimin, etiketimin, ruajtjen e përkohshme dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve janë më të qarta. Pritet që menaxhimi i mbetjeve spitalore pas miratimit të këtij akti të jetë krejtësisht i rregulluar dhe në koshat e mbetjeve urbane të mos hidhen më mbetjet spitalore duke i shpërndarur të gjitha mbetjet urbane me një rrezikshmëri të lartë. Individët prodhues të mbetjeve spitalore, kur këto prodhohen gjatë vetëmjekimit ose gjatë shërbimit mjekësor në banesë, janë të përjashtuar nga fusha e veprimit të aktit të propozuar. Prodhuesit e mbetjeve spitalore duhet të pajisen me kod unik, që do të përdoret në rast transfertash të mbetjeve. Çdo prodhues i mbetjeve spitalore duhet të ketë një plan menaxhimi të mbetjeve, që e përditëson sa herë është e nevojshme por jo më vonë se çdo 3(tre) vjet.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Gjatë përgatitjes së projektaktit, është analizuar një gamë e gjerë legjislacionesh, konkretisht:

- Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
- VKM nr.178, datë 06.03.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Propozimi i këtij akti nuk përfron asnjë direktivë apo rregullore të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti i propozuar ka në përmbajtje kryesisht vendosjen e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve spitalore.

Në kreun e parë të tij janë dispozita të përgjithshme që përfshijnë objektin, qëllimin, fushën e zbatimit, përkufizimet e termave të përdorura në këtë vendim si dhe fusha e veprimit.

Në kreun e dytë janë parashikuar detyrimet/përgjegjësitë e zotëruesve të mbetjeve spitalore duke përfshirë detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore, regjistrimi i tyre, detyrimet e dorëzuesit dhe të marrësit të mbetjeve spitalore si dhe detyrimet e trajtuesit dhe asgjësuesit për këto lloj mbetjesh.

Në kreun e tretë trajtohen çështjet e menaxhimit të mbetjeve spitalore duke përfshirë planin për menaxhimin e mbetjeve spitalore, grumbullimin e ndarë të tyre, ambalazhimin, etiketimin, magazinimin e përkohshëm, transportin, rikuperimin si dhe trajtimin e këtyre lloj mbetjesh.

Çdo prodhues e dorëzues i mbetjeve spitalore pajiset me kodin unik në përputhje me VKM 371/2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, i ndryshuar, ndërsa çdo marrës i këtyre mbetjeve të pajiset me leje mjedisi, licencë dhe akt miratimi higjeno-sanitar sipas kërkesave ligjore në fuqi. Sa i takon procedurës së regjistrimit të prodhuesve të mbetjeve spitalore, prodhuesi regjistrohet në AKM, brenda 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e vendimit. Në rast ndryshimesh, në strukturën e pronësisë, emerërtimin, vendodhjen, mënyrën e veprimtarisë ose për ndonjë ndryshim në veprimtarinë e tij, që mund të ketë ndikim në llojin dhe sasinë e mbetjeve spitalore të gjeneruara, njofton me shkrim Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, brenda 30 ditësh.

Në kreun e katërt janë parashikuar kërkesat higjeno-sanitare që duhen patur parasysh për enët e ripërdorshme, kontenierët për magazinim të përkohshëm,

karrocac për transferim, mjediset për magazinim të përkohshëm si dhe kërkesat e sigurisë.

Në kreun e pestë, është trajtuar procesi i ruajtjes së të dhënave dhe përcaktimi i kërkesave për raportimin e të dhënave të mbetjeve spitalore.

Në kreun e gjashtë janë trajtuar inspektimet dhe masat administrative për mospërbushje të kërkesave të këtij vendimi, ku detyrat dhe përgjegjësitë e secilës strukturë inspektuese janë shprehur në mënyrë tabelare në shtojcën 8.

Gjithashtu pjesë e projektvendimit janë dhe shtojcat të cilat lidhen direkt me kërkesat që duhet të përmbushin mbetjet spitalore për t'u menaxhuar sipas standardeve mjedisore, kërkesat që duhet të përmbushin enët e mbetjeve spitalore, lista e kodeve në katalogun e mbetjeve ku janë të përcaktuara këto mbetje, etiketimi që duhet të kenë enët e mbetjeve spitalore, kushtet për magazinim, kushtet për transportin e mbetjeve spitalore, metodat që përdoren për trajtimin e mbetjeve spitalore, pajisjet që duhen përdorur për mbrojtje personale si dhe detyrat/përgjegjësitë që ka secila strukturë inspektuese për mbetjet spitalore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen:

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përfshirë dhe strukturën inspektuese.
2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe struktura inspektuese për shëndetësinë.
3. Njësitë e Vetqeverisjes Vendore nëpërmjet strukturës inspektuese bashkiake.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektaktit kanë kontribuar ekspertë të ministrisë përgjegjëse për mjedisin në bashkëpunim me ekspertë të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë si dhe strukturat inspektuese respektive.

Projektakti do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si edhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Gjithashtu, akti do të publikohet në faqen e konsultimit publik dhe parashikohet zhvillimi dhe i dëgjësave publike me grupet e interesit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektakt nuk sjell shpenzime shtesë buxhetore, pasi strukturat që do të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi, janë aktualisht të ngritura dhe funksionale.

MINISTËR



MINISTËR

